



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 757/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.11.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e shoqërisë “Murati D” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-29305-10-10-2017 me objekt: “Baze e bute”, Loti II, me fond limit 2.416.000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 23.10.2017, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr.2” Tiranë.

Ankimues:

“Murati D” sh.p.k
Rr. e Kavajës, ish Kombinati Ushqimor, Godina 1-katëshe,
Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr.2”
Rruga “Artan Lenja”, Fusha e Aviacionit,
Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.10.2017 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. Ref-29305-10-10-2017 me objekt: “*Baze e bute*”, Loti II, me fond limit 2.416.000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 23.10.2017, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve Nr.2*” Tiranë.

II.2. Në datën 30.10.2017 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar.

Sipas këtij klasifikimi renditja e ofertave pa TVSH, është si më poshtë:

1. “Murati D” sh.p.k	1.578.000 lekë, skualifikuar
2. “Mega Plast-2L” sh.p.k	1.848.000 lekë, skualifikuar
3. “Blerina Kapedani”sh.p.k	1.885.200 lekë, kualifikuar
4. “Himi” sh.p.k	1.890.000 lekë, skualifikuar
5. “Paera” sh.p.k	1.920.000 lekë, kualifikuar
6. “Shaga” sh.p.k	2.070.000 lekë, skualifikuar
7. “Atlantik 3” sh.p.k	2.100.000 lekë, skualifikuar
8. “Bold” sh.p.k	2.220.000 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k rezulton i skualifikuar me argumentat e mëposhtme:

“Ne baze te ligjit te Prokurimit Publik Nr.9643 date 20.11.2006 i ndryshuar si dhe VKM nr.914 date 29.12.2014, per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik, oferta rezulton anomalisht e ulet.”

II.3. Në datën 02.11.2017 operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e mësipërme e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“Në datën 30.10.2017 nëpërmjet rrugëve elektronike morëm njoftimin se KVO ka skualifikuar ofertën tonë për arsyen se oferta jonë është cilësuar në bazë të formulës si ofertë anomalisht e ulët. Ky fakt që parashtrorj në KVO ditën që mësuam me datë 30 na erdhi si bombë pasi nëpërmjet rrugëve elektronike sic veprohet zakonisht, duhet të ishim informuar për të dhënë argumentime për pretendimin e KVO-së, por këtë e mësuam vetëm më datë 01.11.2017 se kishte ardhur një kërkesë e tillë nga KVO me një shkresë zyrtare që përmbante datën 24.10.2017 që deri më datë 27.10.2017 kërkonte një sqarim, argumentim në lidhje me cmimin e ofertës sonë. Pas marrjes së shkresës u interesuam në degët e postës dhe ata sqaruan se kjo shkresë është nisur jo më 24 por është rregjistruar nga Posta në mesin e ditës 26.10.2017 dhe nesër është bërë aktive për ta dërguar në adresën përkatëse pra me datë 27.10.2017. Ato duhet ta kishin sjellë tek ne por ajo për fat të keq arriti tek adresa e dërguar vetëm me datë 31.10.2017 ku një ditë para, pra me datë 30.10.2017 KVO kishte kryer vlerësimin ku në përgjigjen e tyre u habitëm se nga e nxorrën këtë konkluzion.

Pra ne nuk jemi njoftuar për këtë kërkesë të KVO-së. Mosinformimi është defekt i dy palëve si AK apo KVO sepse janë bërë dy shkelje për të krijuar një anash kalim ndaj subjektit tonë qëllimi i qartë që të mos jepnim argumentimin e duhur.

Së pari është mashtruar me datën e njoftimit pasi kërkesa është dërguar pas orës 12.00 të datës 26 dhe aspak në datën 24.10.2017 sic thuhet në zarfën përcjellës ku dhe vetë zarfi ka vulën e postës datë 26 dhe 27 tetor. Këto i sqaruam dhe me shërbimin postar ku sipas postës të kompjuterizuar theksohet se marrja është bërë pasditen e datës 26.10.2017 dhe jo me datë 24.10.2017 sic është shkruar në datën e letrës ku me datë 27 duhet të kishim kthyer përgjigje kur lajmërimi ka arritur në zyrën tonë vetëm më 31.10.2017. Prandaj dhe për këtë kërkoj një sqarim nga ana juaj e një pezullim të vlerësimit të ofertave.

Së dyti po të ishte e interesuar KVO-ja për përgjigje do të kishte shfrytëzuar rubrikën e AK ku të kishte informuar nëpërmjet rrugëve elektronike për përgjigje ose telefonin, që kërkesën ta kishim marrë direkt me zarf, ashtu sic është vepruar dhe në raste të tjera. Por për të shmangur përgjigjen e argumentimin ka zgjedhur një rrugë që të mos merrnin përgjigje sepse ajo i hidhëronte për të marrë vendimin.

Pra kërkojmë nga autoriteti juaj që të pezulloni këtë vendim të KVO pasi arsyeja e mospërgjigjes është mungesa e informimit si nga KVO se ka mashtruar me datën e shkresës që kërkon argumentimin e ofertës si dhe nga ditët e pushimit të vetë postës ku lajmërimi ka ardhur pas vendimit të KVO-së për tenderin. Gjithashtu duhet ti rikujtoj KVO-së se argumentat i ka patur të pasqyruar në kontratën me Bashkinë Fier me objekt: “Blerje materiale të imta”. Në këtë kontratë janë pasqyruar cmimet e materialeve që ishin objekt i tenderit si carcafët, këllëfët batanije dhe jastëkët ku ndryshimi i cmimit shitës me cmimet e ofertës janë shumë ndryshuese, po i rradhisim: carcafët

në Fier janë tregtuar me 200 lekë/copa ose kompleti me 400 lekë/kompleti kurse në ofertë kemi një komplet carcafish (është pasqyruar) me 880 lekë/kompleti, një ndryshim me 480 lekë/kompleti më i lartë, 2- Batanije nga 850 lekë/copa e realizuar në QEA tek oferta jonë është 940 lekë/copa një ndryshim me 90 lekë/copa, së fundi një jastëk është tregtuar me 250 lekë/copa nga 330 lekë/copa tek oferta juaj. Vetëm ky argument që KVO e kanë vetë përpara syve të pasqyruar në faturat e shitjes dhe të realizuar me sukses sic vërteton dhe vërtetimi i AK Fier e vërteton këtë të vërtetë. Në këtë mënyrë dua të them se ato argumentin e kishin në dokumentacionin e dorëzuar në tenderin përkatës. Përveç këtij argumenti ne do të kishim sjellë dhe argumenta nga prodhuesi e shitja që i bëjnë operatorit tonë prodhuesi. Por duke u nisur nga cmimet e larta që ato kanë pasqyruar në tende, e dinin fare mirë koston e objektit të tenderit dhe në këtë mënyrë ato zgjodhën rrugën e mosinformimit tonë dhe të vlerësimit të tyre verbal e aspak ligjor. Dhe njëherë kërkoj që ky vlerësim nuk i përmbush kushtet ligjore të vlerësimit por është subjektiv, i pandershëm dhe i përzgjedhur. Për qëndrimin e komisionit të vlerësimit të mostrave mund të theksoj të njëjtat probleme që theksova për lotin e parë. Përfundimisht kërkojmë nga ana juaj që të shqyrtoni kërkesën tonë brenda standardeve konkurrues dhe ato ligjore dhe të kualifikohemi në këtë procedurë.”

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 406/3 prot., datë 06.11.2017 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit duke e refuzuar ankesën si më poshtë:

“Referuar ankesës suaj nr. 406 prot., datë 02.11.2017 paraqitur nga operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k, në të ngrihen pretendimet se:

“Autoriteti kontraktor ka kryer skualifikim të padrejtë të operatorit ekonomik “Murati D” sh.p.k pasi ka gjykuar se: “Marrja e kërkesës për sqarimet në lidhje me mënyrën e llogaritjes së cmimit të ofertës është në datë 01.11.2017”.

Titullari i autoritetit kontraktor, pasi u njoh me akuzën tuaj [...] ngriti komisionin [...] për shqyrtimin e ankesës nr. 406 prot., datë 02.11.2017 të bërë nga operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k.

Komisioni mbasi u njoh me ankesën dhe mbas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit të nevojshëm të vënë në dispozicion nga njësia e prokurimit konstatoi se:

“ Në bazë të LPP-së dhe rregullave të prokurimit publik oferta e shoqërisë “Murati D” sh.p.k rezulton anomalisht e ulët.

Përsa më sipër komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesës konstatoi se:

Pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k për skualifikimin nga tenderi nuk qëndrojnë pasi arsyet e skualifikimit të kryera nga KVO janë të qarta dhe jo ato që ka paraqitur në ankesë operatori ekonomik.

Referuar nenit 66, pika 5 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Komisioni i Vlerësimit të Oferatve vlerëson nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me cmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentat e tenderit. Me përlllogaritjen e vlerës së ofertës së sjellë nga ofertuesi ekonomik “Murati D” sh.p.k rezultoi nga ana e KVO-së se oferta e operatorit është anomalisht të ulët. Pas kësaj KVO-ja [...] kërkoi sqarime nga operatori ekonomik mbi mënyrën e përlllogaritjes së cmimit të ofertës së operatorit.

Kjo vërtetohet me kërkesën e drejtuar operatorit ekonomi “Murati D” sh.p.k me shkresën nr. 382 prot, datë 24.10.2017 në të cilën janë kërkuar sqarime dhe këto sqarime të paraqiteshin brenda

datës 27.10.2017, referuar LPP-së. 'Ofertuesi nuk ka paraqitur sqarime në lidhje me mënyrën e përlllogaritjes së ofertës dhe nga kjo ju si ofertues jeni skualifikuar nga KVO, në përputhje me ligjin.

Komisioni i ngritur me urdhërin e titullarit të autoritetit kontraktor gjykon se skualifikimi nga ana e KVO-së është në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik.

[...] Autoriteti kontraktor vlerësoi se pretendimet e ngritura në ankesën nr.406 prot., datë 02.11.2017 të operatorit ekonomi "Murati D" sh.p.k të mos merren në konsideratë."

II.5. Në datën 14.11.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si vijon:

"Në datën 30.10.2017 nëpërmjet rrugëve elektronike u njoftuam nga Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve nr.2 se oferta jonë është refuzuar nga KVO-ja për vetë arsyen se oferta jonë është vlerësuar si ofertë anomalisht e ulët e si e tillë kërkonte argumentimin e vlerës së paraqitur në tender. Kërkesën për të paraqitur argumentat AK i ka dërguar me postë , si e tillë letra është vonuar dhe ka arritur në zyrën tonë vetëm me datë 31.10.2017, një ditë më vonë se AK bën vlerësimin e ofertave. Për këtë mungesë sinjalizimi u interesuam tek posta dha ata na sqaruan: -Letra e AK ka ardhur në postë me datë 26.10.2017 pasdite dhe ne jemi interesuar ta sjellim atë me datë 27.10.2017, ditë që ne duhet të kishim dërguar argumentimin sipas afatit të kërkuar nga KVO e AK. Por shkresa arriti 4 ditë më vonë. Arsyja është, përgjigjet posta, se korieri i asaj linje ka qënë me leje dhe korieri i ri nuk e ka gjetur adresën tonë. Bëjmë pyetje pse nuk është kthyer atëherë në destinacionin e duhur por vjen me datë 31 tek zyra, në këtë datë gjendet adresa. Ne pas sqarimit verbal me përfaqësues të postës i drejtohem i shkresë Drejtorit të Shërbimit Postar me datë 01.11.2017 me nr. prot.1578 ku i kërkojmë sqarime përse nuk ka arritur posta në kohën e duhur kur e ka marrë shkresën dhe kur e ka vënë në shërbim të shpërndarjes zarfën tek zyra jonë dhe përse është vonuar kaq gjatë. Drejtori i Filialit nëpërmjet shkresës datë 10.11.2017 nr.1578/1 prot., sqaron: 1-Shkresa me nr. 382 prot., datë 24.10.2017 është dorëzuar në postë me datë 26.10.2017, e thënë ndryshe 2 ditë më vonë që shkresa mban datën e nisjes, jo 24 por shkresa duhet të kishte datën 26.10.2017. Më poshtë Drejtori sqaron se ky objekt ka kaluar në shpërndarje me datë 27, 28, 30.10.2017, pasi data 29 përkon ditë pushimi. Me fjalë të tjera objekti ka hyrë në shpërndarje, ku më datë 27.10.2017 duhet të kishim dërguar përgjigjen pranë AK për ofertën anomalisht të ulët. Drejtori, shkresë të cilën do jua përcjellim edhe juve, i sqaron vonesat dhe arritjen e kërkesës së AK në zyrën tonë me datë 31.10.2017, ku AK kishte bërë shpalljen një ditë para më datë 30.10.2017 dhe oferta jonë ishte refuzuar për të njëjtën arsye se ne kishim ofertën anomalisht të ulët dhe nuk kishim dërguar përgjigjen deri më datë 27.10.2017.

Në ankesën drejtuar AK e sqaruam këtë problem këtë vonesë të marrjes së kërkesës së tyre, duke ua shtjelluar arsyen se pse nuk ka ardhur në kohë përgjigja dhe i kërkuar rivlerësim të ofertave, por komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesave nuk pranoi dhe e quajti të rrem dëshminë tonë dhe nuk e mori mundimin për sqarime të mëtejshme. Gjithashtu ne i kërkuam AK-së se përse KVO nuk kishte përdorur dhe rrugët elektronike tek sistemi apo telefon etj mënyra komunikimi por vecanërsiht rrugët elektronike të ligjshme si të gjithë institucionet. Ne nuk morëm përgjigje aspak për këtë kërkesë por përgjigja ishte e qartë -që argumenti të mos arrinte në kohë- dhe ata të bënin vlerësimin sic e bëne me datë 06.11.2017 ku dhe kjo shkresë arriti me 08.11.2017, por nuk u vonua si e para 5 ditë. Duke

u nisur nga këto fakte pretendojmë se vlerësimi i ofertave nga KVO është i jashtëligjshëm prandaj kërkojmë kualifikimin e ofertës sonë.


Ndalemi më poshtë: Në sistem me datë 13.11.2017 u shfaq rivlerësimi i ofertave si më poshtë:

1. "Murati D" sh.p.k	1.578.000 lekë, skualifikuar
2. "Mega Plast-2L" sh.p.k	1.848.000 lekë, kualifikuar
3. "Blerina Kapedani" sh.p.k	1.885.200 lekë, kualifikuar
4. "Himi" sh.p.k	1.890.000 lekë, skualifikuar
5. "Paera" sh.p.k	1.920.000 lekë, kualifikuar
6. "Shaga" sh.p.k	2.070.000 lekë, skualifikuar
7. "Atlantik 3" sh.p.k	2.100.000 lekë, skualifikuar
8. "Bold" sh.p.k	2.220.000 lekë, skualifikuar

Përfundimisht në fazën e dytë, si duket pas ankimit për skualifikim të padrejtë në fazën e parë të datës 30.10.2017, e kualifikojnë shoqërinë "Mega Plast 2L" sh.p.k me vlerë 1.848.000 lekë, kurse pretendimin e ankesës sonë nuk e morën aspak parasysh.

Nga rivlerësimi i ofertave në fazën e dytë rrjedh se vlerësimi i parë nuk ka qënë i drejtë dhe se me këtë rivlerësim të datës 13.11.2017 oferta jonë nuk është anomalisht e ulët [...]."

II.6. Në datën 22.11.2017 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1696/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 442/2 prot., datë 20.11.2017 me objekt: "Dërgohet informacion", bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.



pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues "Murati D" sh.p.k sipas së cilës: "Ne baze të ligjit të Prokurimit Publik Nr.9643 date 20.11.2006 i ndryshuar si dhe VKM nr.914 date 29.12.2014, për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik, oferta rezulton anomalisht e ulët", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Sipas njoftimit të klasifikimit përfundimtar të ofertave të datës 30.10.2017 renditja e oferta rezulton si vijon:

1. "Murati D" sh.p.k	1.578.000 lekë, skualifikuar
2. "Mega Plast-2L" sh.p.k	1.848.000 lekë, skualifikuar
3. "Blerina Kapedani" sh.p.k	1.885.200 lekë, kualifikuar
4. "Himi" sh.p.k	1.890.000 lekë, skualifikuar
5. "Paera" sh.p.k	1.920.000 lekë, kualifikuar
6. "Shaga" sh.p.k	2.070.000 lekë, skualifikuar

- | | |
|------------------------|------------------------------|
| 7. “Atlantik 3” sh.p.k | 2.100.000 lekë, skualifikuar |
| 8. “Bold” sh.p.k | 2.220.000 lekë, skualifikuar |

III.1.2. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.1.3. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]”

III.1.4. Nga përlllogaritjet e kryera në zbatim të nenit 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si më sipër cituar, rezulton se oferta e operatorit ekonomik “Murati D” sh.p.k nuk është ofertë anomalisht e ulët. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Pretendimi i ankimuesit qëndron

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. Ref-29305-10-10-2017 me objekt: “Baze e bute”, Loti II, me fond limit 2.416.000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 23.10.2017, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr.2” Tiranë”.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Murati D” sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë ofertues.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k” sh.p.k
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1696 Protokoli,
Datë 14.11.2017



KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha